



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:107363
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05568604

PA1.nr.1237/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.M dhe M.M nga Prishtina, për shkak të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 437par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së përbashkët të akuzuarit M.M dhe mbrojtësit të të akuzuarës M.M, av. I.D si dhe ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2028/18 të dt.18.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e përbashkët e të akuzuarit M.M dhe mbrojtësit të të akuzuarës M.M, av. I.D dhe ankesa e Prokurorisë Themelore në, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2028/18 të dt.18.05.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.2028/18 të dt.18.05.2022, të akuzuarit M.M dhe M.M i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 437par.2 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarës M.M i ka shqiptuar

dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në shumë prej 1,000 (një mijë) euro, të cilin dënim e pandehura është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës me 1 (një) ditë burgim. Të pandehurit M.M i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetë qind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës me 1 (një) ditë burgim. Obligohen të pandehurit M.M dhe M.M që secili veç e veç të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale paushallin gjyqësorë në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, kurse në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civilo juridik.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës që të aprovoj në tërësi ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi sanksionin penal dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet dënim më i rënd me burg.

Ankesë të përbashkët kanë parashtruar i akuzuari M.M dhe mbrojtësi i të akuzuarës M.M av, I.D për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit t'i liroj nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën ngarkohen ose aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën të kthej në Gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1275/22 të datës 23.08.2022, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet dënim me burgim më të rëndë, ndërsa të refuzohet ankesa e përbashkët e të të akuzuarit M.M dhe mbrojtësit të të akuzuarës M.M, av, I.D si e pabazuar.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari, M.M dhe mbrojtësi i të akuzuarës, M.M, av. I.D. Prokurori i Apelit dhe e akuzuara M.M, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt

nuk prezantuan në seancë. Mbrojtësi i të akuzuarit M.M, av, I.D, deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar duke shtuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të mbështes vendimin e saj në prova të qëndrueshme, por përfundimin e vetë e ka mbështetur në prova të dyshimta, të pasigurta dhe skajshmërisht jo valide (të papranueshme) sepse deklarimi i pasurisë nga ana e të akuzuarve është bërë me kohë .I propozon gjykatës që të refuzohet ankesa e parashtruar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të akuzuarit të lirohen nga përgjegjësia penale-të lirohen nga akuza. I akuzuari, M.M deklaroi se e përkrah fjalën e avokatit I.D dhe i kundërshton në tërësi pretendimet ankimore në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ngase sipas tij që nga fillimi kanë qenë tendencioz. E konsideron veten të pafajshëm dhe deklaroi se asnjëherë nuk ka pasur kundër tij kallxim penal. Tutje, shton se raportin e deklarimit të pasurisë e kanë paraqitur 8 (tetë) muaj para se të filloj procesi dhe prokuroria pas 8 (tetë) muajsh ka filluar procesin me pretendimet se ne kemi fshehur pasurinë. Deklaron se i njëjti është qytetar i përgjegjshëm, pensionist dhe ka punuar në arsim për 40 (dyzetë) vite dhe se nuk kanë dëmtuar askënd. Kërkon nga gjykata që të lirohen nga përgjegjësia penale – të lirohen nga akuza .

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesat nuk janë të bazuara.

Prokuroria Themelore në Prishtinë e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me pretendimet se dënimi i shqiptuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë është i ulët dhe se nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë, si dhe nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjësive penale të të akuzuarve, ngase në rastin konkret për veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 437 par.2 të Kodit Penal të Kosovës, parashihet dënimi më gjorbë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet. Tutje , pretendon se dënimi është i butë, edhe pse gjykata ka marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, por dënimi i shqiptuar nuk është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, prandaj ky dënim nuk do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave të tjerë në kryerjen e veprave penale. I propozon Gjykatës e Apelit të Kosovës që të aprovoj në tërësi ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi sanksionin penal dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet dënim më i rënd me burg.

I akuzuari M.M dhe mbrojtësi i të akuzuarës, M.M, av. I.D e ankimojnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që ky aktgjykim nuk përmban faktet mbi bazën e të cilave do të vërtetoheshin tiparet e kësaj vepre penale, mbi bazën e të cilave fakte kjo gjykatë kishte për t'a mbështetur vendimin e vetë dënues, andaj një e metë e tillë paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që

aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare, kjo mund të shihet nga përmbajtja e arsyetimit ku faktet vetëm përmenden e nuk sqarohet përmbajtja e tyre në dimensionin kundërshtues dhe provues, përkatësisht aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 paragrafi 7-11 të Kodit të Procedurës Penale. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë bërë nga gjykata e shkallës së parë, për çfarë në kundërshtim me nenin 384 par.1 nën par. 1.8 të KPPRK, aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme. Kështu arsyet bëhen të paqarta, ngas e ekziston në një masë e konsiderueshme kontradiktë e theksuar midis asaj çka paraqitet në arsyet e aktgjykitimit të cilat kundërthënie janë kontradiktore me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të pandehurve dhe dëshmitares në njërën anë dhe përfundimet e nxjerra në anën tjetër. Nuk ka fare analizë thelbësore në raport me institutin e dashjes, por arsyetimi i pretenduar është i përgjithësuar, dhe nuk ka mbështetje në veprimet konkrete të raportit volutiv, pa të cilin edhe nuk ka përgjegjësi penale. Mungesa e një analize të tillë, në këtë dimension, duke përfshirë edhe qëllimin dhe motivin, paraqet shkelje esenciale të dispozitave procedurale, andaj aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndroj, me qenë se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me gjetjet nga provat e administruara. Është i pakontestueshëm fakti se deklaratat fakti se deklaratat kanë rendësin e tyre, por përparësi dhe supremaci definitive kanë provat substanciale, materiale, reale e solide, e meqë të tilla nuk duken asgjekund, pranueshmëria e këtyre deklaratave nga gjykata, që Prokurori i quan prova, është absurde. Gjykata e shkallës së parë bën gabimin kur deklaratës së të vetmit dëshmitar znj. A, pjesërisht ia falë besimin, por këtë e bënë në kundërshtim me provat materiale, për më tepër dëshmitarja nuk ishte person i vështrimit okular të veprimeve apo mosveprimeve të të dyshuarve. Pesha e një dëshmie, lidhet me veprimet e kohës, kur supozohet kryerje e veprës penale e jo me ndodhitë e ardhshme. Kështu, dëshmitarja znj. L.A, nuk ishte e punësuar në AKK, në kohën për të cilën aktakuza përshkruan pretendimet faktike dhe e njëjta nuk kishte informacion për të zbardhur qoftë edhe të një fakti. Atë që deklaroi znj.A, kishte të bënte me interpretime ligjore, si një "eksperte" e interpretimit ligjor e jo dëshmitare okulare, e që është detyrë e gjykatës interpretimi dhe zbatimi i ligjit. Kjo dëshmi ishte një deklaram, në tërësi paragjykes, në ngarkim të të akuzuarve, por, jo ndriçim i fakteve relevante që do të paraqesin dhe vërtetonin elementet e veprës penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë, nuk jep asnjë arsyetim lidhur me pretendimet e mbrojtjes se në rastin konkret eventualisht ky rast mund trajtohet si mos deklaram brenda afatit sipas par.1 të nenit 437 të KPRK-së e jo me Mos deklaram lidhur me fshehjen apo falsifikimin e të dhënave (..), që ndërlihet me veprimet apo mos veprimet lidhur me këtë çështje, gjë që këtë aktgjykim e bënë të munguar në arsyetimet qenësore të pretendimeve të të akuzuarve dhe mbrojtjes.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë, si dhe as shkelje tjera të procedurës, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykitimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369

par. 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridiko penale, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të përgjegjësisë penale të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjyqimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprave penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë edhe mbrojtjen e të akuzuarve, kështu që përfundimet e gjykatës së shkallës së parë sa i takon mbrojtjes së tyre, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i akuzuari M.M dhe mbrojtësi i të akuzuarës, M.M, av. I.D në ankesën e përbashkët pretendojnë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike, përkatësisht gjendjen faktike gabimisht e ka vënë nën dispozitat materiale. Gjykata nuk e ka provuar se veprimet apo mosveprimet e të akuzuarve veç e veç përbëjnë elemente ndëshkuese të kualifikuara si kryerje e veprës penale, kjo për më tepër , reflekton mungesën e të provuarit për akuzën që i vihet në barrë të akuzuarës znj. M, pa përjashtuar edhe z. M. Asnjë rrethanë faktike nuk çon në nxjerrjen e konkluzionit se znj. M as vetë e as me bashkëshortin, të kenë qenë pjesë e veprimeve inkriminuese të supozuara nga Prokurori i Shtetit. Asnjë fjalë të gjykatës nuk e gjejmë në përpjekjet për të arsyetuar aktgjykimin dënues, në drejtim të fakteve të pretenduara lidhur me të qenurit pjesë e veprimit vetëm apo bashkë me të tjerët nga znj.M. Gjykata nuk jep asnjë bazë për të treguar ‘rolin ‘ e të akuzuarës M. Nuk ka lidhje të hallkave të zingjirit të pashkëputshëm për të vënë në pah faktin e supozuar se kinse znj. Meha ka qenë pjesë e veprimit apo mos veprimit në drejtim të kryerjes së veprës penale që i vihet në barrë, po ashtu edhe ndaj z. Meha. Kështu, nga analiza e secilës provë veç e veç, dhe analiza në aspektin komulativ të tyre, vie në përfundim se nuk është provuar se të akuzuarit M, kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nga prokurori i shtetit dhe janë gjetur fajtor nga gjykata e shkallës së parë. Lidhur me shkeljet e Ligjit penal , avokati mbrojtës I.D pretendon se vendosja lidhur me aprovimin e pjesërishëm të aktit akuzues , lidhur me akuzën për mos deklarim të NK.nr.202-10, është në kundërshtim të tërësishëm me dispozitat ligjore materiale. Gjykata e shkallës së parë, pos tjerash ka aplikuar gabimisht nenin 437 par.2 të LP të RK-së, ngase nuk ka të bëjë me konsumimin e elementeve të veprës penale nga të pandehurit. Por, në këtë rast kryesiale është trajtimi që ndërlidhet me zbatimin e Ligjit Penal më të favorshëm, siç është përcaktuar në nenin 3,të KPRK-së, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013, e të cilat dispozita kanë qenë të parapara edhe në Kodin Penal të Kosovës, por në nenin 2 , i zbatueshëm që nga viti 2004 e deri në fund të vitit 2012, dhe tani këtij të fundit. Në rastin konkrete, ligji i vjetër nuk e ka sanksionuar veprën penale për të cilën ngarkohen këtu të akuzuarit. Vlenë të theksohet se me rastin e krahasimit se cili ligj është më i butë për kryesin e veprës penale konkrete, duhet të aplikojë njërin prej ligjeve , por jo në mënyrë të kombinuar të dispozitave të ligjit që ka pushuar së vepruari dhe të ligjit që gjendet në fuqi, sepse, po të lejohej mundësia e tillë, atëherë gjykata në fakt krijon ligj të ri penal , përkatësisht do ta gjykonte kryesin e veprës penale sipas ndonjë ligji që nuk ka qenë në fuqi asnjëherë. Meqenëse, me KPRK-së, kur edhe është blerë paluajtshmëria, ka qenë në fuqi Kodi Penal i vjetër (i aprovuar me 2004, ndërkaq ligji i ri në fuqi është nga 1 janar 2013), me të cilin Kod Penal nuk ishte paraparë vepra penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose dobisë tjetër materiale ose i

detyrimeve financiare nga neni 437, par.2 të KPRK-së (2004- Kodi i vjetër), ndërkaq sipas aktakuzës kjo veprë penale është kryer para hyrjes në fuqi të Kodit t Ri Penal, duhet të zbatohet Ligji material më i favorshëm për të akuzuarit, e që në rastin konkret është Kodi Penal i Republikës së Kosovës , i cili ishte ne fuqi deri me 31 dhjetor 2012, kjo ngase me këtë kod nuk është paraparë vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit. Nga ana tjetër, Kodi i ri që e ka përcaktuar veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPRK-së, duke mos qenë i favorshëm për të pandehurit, nuk e përmbush kushtin themelore të ligjit-zbatimit të ligjit më të favorshëm, ngase me Kodin e Ri është paraparë vepra penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPRK-së nga neni 437 par.2 të KPRK-së, e cila nuk ka qenë paraparë me Kodin e Vjetër Penal, ndërkaq blerja e patundshmërive ka ndodhur në vitin 2012 , pra deri sa ishte në fuqi Kodi Penal i Vjetër , që është ligji më i favorshëm për të pandehurit. Lidhur me pretendimet mbi vendimin mbi dënimin, pretendon se shpenzimet dhe paushallin gjyqësorë është i pa qëndrueshëm dhe kundërligjor dhe propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit t'i liroj nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën ngarkohen ose aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën të kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike nuk qëndrojnë, sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesë. Se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe gjykuar, me pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar nga provat si ato personale dhe ato materiale si: Procesverbali i datës 25.01.2017 mbi marrjen ne pyetje të pandehurës M.M, Procesverbali datës 23.11.2017 dhe datës 29.11.2017 mbi marrjen ne pyetje të pandehurit M.M, Fotodokumentacioni, Prova AKK, nr.02-01/40660/05 e datës 12.15.2015, shkrimi ne gazetën Zeri.info me titull: Meha fshehu pasurinë, Kërkesa e datë 13.01.2017, Vërtetim nga Komuna e Graçanices, datës 20.01.2017, Aktvendim me nr.409/13 te dt.03.04.2013, Certifikata Kadastrale e datës 02.02.2016, Aplikimi për regjistrimin e pasurisë datë 27.03.2013, Kontrate mbi shitblerjen e pronës se paluajtshme e datës 03.05.2012 nr.1574/2012 te dt.04.05.2012, Urdhërpagese kombëtare atë 04.05.2012, ref.5329057920, Certifikate e pronësisë dt.27.03.2013, Parashtrere, nr.6922/15 dt.25.11.2015, Certifikate me nr.34-13621 dt.24.11.2015, Certifikate me nr.UL-73414042-00963 dt.27.03.2013, Sqarim ne kërkesën AKK-02-4066/15, dt.21.12.2015, Sqarim ne kërkesën AKK-02-4066/15 i dt.21.01.2016, Sqarim ne kërkesën AKK-02-4066/15 datë 12.01.2016, Formular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë dt.29.03.2013 për M.M, Formular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë dt.20.03.2014 për M.M, Formular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë, dt.20.03.2015 për M.M, Fomular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë dt.29.03.2013 për M.M, Formular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë dt.20.03.2014 për M.M, Formular për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë dt.20.03.2015 për M.M Vërtetim-njoftim nr.297/17 dt.20.01.2017 nga Komuna e Gracanices për M.M, pjesërisht edhe nga dëshmia e dëshmitares L.A, pjesërisht edhe nga mbrojtja e të akuzuarve.

Nga të lartcekurat ky kolegji vlerëson se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë se duhet falë besimin këtyre provave, ngase të njëjtat ishin në harmoni me njëra tjetrën nga të cilat përtej çdo dyshimi vërtetohet se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet si në përshkrimin faktik të veprave penale të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit, për çka gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e saj e të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe ky kolegji, dhe nuk e sheh të arsyeshme të japë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Kolegji i kësaj gjykate e vlerësoj si të drejtë konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se e akuzuara M.M ka qenë e obliguar të bëjë deklarin e rregullt të pasurisë për periudhën 01-31 mars 2014 (për vitin paraprak 2013), ka qenë e obliguar që ta deklarojë paluatshmërinë me sipërfaqe prej 450 m2, e evidentuar me numër P-202-10, ZK ...1, dhe e regjistruar ne emrin e të akuzuarës Miradije Meha me datë 27.03.2013 në regjistrat Kadastral të Komunës së Gracanicës, ku me rastin e regjistrimit te paluajtshmerisë me sipërfaqe prej 450 m2, e evidentuar me numër P-202-10, ZK ...1, në regjistrat kadastral ne emrin e të akuzuarës, e akuzuara është bërë pronarë e kësaj paluatshmërie, fakt të cilin e akuzuara M.M e ka pohuar edhe ne dokumentin – sqarimin të cilin i ka bërë AKK-së, me referencë AKK-02-4066/15, dt. 21.12. Po ashtu se i akuzuari M.M ne deklarin e rregullt të pasurisë për periudhën 01-31 mars 2014 (për vitin paraprak 2013), ka qenë i obliguar që ta deklarojë paluajtshmerinë me sipërfaqe prej 450 m2, e evidentuar me numër P-202-10, ZK ..., dhe e regjistruar ne emrin e bashkëshortës së tij, të akuzuarës M.M me datë 27.03.2013 në regjistrat Kadastral të Komunës së Gracanicës, si pronare e kësaj paluatshmërie, fakt të cilin e ka pohuar edhe vet i akuzuari M.M përmes shkresës sqaruese drejtuar AKK-së me numër të referencës AKK – 02-4066/15 dt. 21.12.2015 e nënshkruar nga i akuzuari M.M, ku ka theksuar se lidhur me parcelën P – 202-10, në shfrytëzim aktual bujqësor, vendi i quajtur Çajne, me siperfaqe 450 m2 ne zonën kadastrale, Komuna Gracanicë, është kontraktuar me 03.05.2012 ndërmjet shitësit D.Z dhe Blerësit M.M (bashkshortja e të akuzuarit M.M), dokumentacioni i kontraktimit ligjor, pronësor dhe teknik janë: kontrata e vertetuar në gjykatë, certifikata mbi të drejtat pronësore dhe kopja e planit nga shitësi, transaksioni bankar dhe pagesa tjera të domosdoshme në Komunë për regjistrimin e paluatshmërisë, regjistrimi i kontraktimit të parcelës P – 202-10 në kadaster është bërë me 27.03.2013 që dmth se nga ky moment znj M.M është pronare e saj. Pra nga të gjitha provat e administruara dhe drejtë të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjykata e shkallës së parë gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 437par.2 të KPRK-së, për çka me të drejtë e shpalli penalisht përgjegjës dhe fajtor. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe Kolegji Penal i kësaj gjykate.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë është aplikuar edhe ligjit penale kur gjykata të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin i të aktgjykimit të ankimuar, ngase në veprimet e të akuzuarit konsumohen të gjitha elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë, në rastin konkret nuk ka rrethana të cilat përjashtojnë kundërligjshmërinë e apo përgjegjësinë penale të akuzuarit. Në rastin konkret është aplikuar ligji penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, drejtë janë aplikuar dispozitat për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit dhe se drejtë

i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.M dhe i akuzuari M.M në preambulën e ankesës së tyre të përbashkët e ankimojnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket vendimit mbi dënimin, shpenzimet e procedurës si dhe paushallit gjyqësorë, mirëpo lidhur me të njëjtët nuk arsyetojnë, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 396 të KPPK-së dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe se nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarit i ka ngarkuar me pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe paushallin gjyqësorë.

Sa i përket pretendimeve të Prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënimin Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë që të akuzuarve ti shqiptohet dënim më i rënd me burg, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me të rëndë për të akuzuarit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurën Miradije Meha se e njëjta ka treguar sjellje korrekte në gjykatë, bashkëpunimin e të pandehurës me organet e ndjekjes gjatë fazës së hetimeve kurse si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin Murat Meha se i njëjti ka treguar sjellje korrekte në gjykatë, bashkëpunimin e të pandehurit me organet e ndjekjes gjatë fazës së hetimeve kurse si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarve, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti liroj nga akuza. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1237/22, më datë 13.02.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Zyhdi Haziri

Ferit Osmani
